**LIGJ**
**Nr. 10 218, datë 4.2.2010**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9363, DATË 24.3.2005 "PËR MËNYRËN DHE PROCEDURAT E VENDOSJES DHE KALIMIT TË FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI DHE PËR DËRGIMIN E FORCAVE USHTARAKE SHQIPTARE JASHTË VENDIT"**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, në fund të pikës 3 shtohen fjalët "apo nga Bashkimi Europian".

Neni 2

Në fund nenit 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Autoritetet kompetente për dërgimin e njësive ushtarake në operacione ushtarake jashtë vendit, në çdo rast, në aktin e dërgimit duhet të përcaktojnë misionin dhe mandatin e këtyre forcave. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në zbatim të misionit dhe mandatit të përcaktuar, miraton rregullat e angazhimit për këto njësi ushtarake.".

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 7
**Operacionet ushtarake ndërkombëtare të organizuara, të autorizuara ose të drejtuara nga NATO-ja apo Bashkimi Europian**

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, vendos për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 3 të këtij ligji, rast pas rasti, duke përcaktuar misionin, nivelin e pjesëmarrjes, kohëzgjatjen e këtij operacioni, si dhe çdo element tjetër të domosdoshëm për mbarëvajtjen e operacionit ushtarak.

2. Dërgimi i njësive ushtarake shqiptare, sipas këtij neni, bëhet vetëm në rastet kur, paraprakisht, është arritur një marrëveshje ndërkombëtare për statusin e forcave ushtarake shqiptare në vendin ku kryhet operacioni ushtarak.".

Neni 4

Në nenin 8, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Vendimi për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në stërvitje e në veprimtari ushtarake ndërkombëtare jashtë vendit merret:

a) deri në nivel kompanie, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes;

b) mbi nivel kompanie, me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “me pëlqimin paraprak të Kuvendit” hiqen.

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 6

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

**Emërimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare**

Personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë emërohet në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.”.

Neni 7

Në titullin e nenit 13 shtohen fjalët “apo Bashkimi Europian”.

Neni 8

Në nenin 14, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Vendimi për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në stërvitje të përbashkëta ushtarake ndërkombëtare, në veprimtari të organizuara, të autorizuara ose të drejtuara nga NATO-ja, Bashkimi Europian apo vendet e tjera, në territorin e Republikës së Shqipërisë, për numër të përgjithshëm pjesëmarrësish, merret:

a) deri në 500 veta, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes;

b) mbi 500-1000 veta, me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) mbi 1000 veta, me ligj nga Kuvendi.”.

Neni 9

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “me pëlqimin e Kuvendit” hiqen.

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 16, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Dhënia e lejes së tranzitimit për forcat ushtarake të vendeve anëtare të NATO-s dhe vendet anëtare të PfP SOFA bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Urdhri u bëhet i ditur menjëherë autoriteteve përkatëse, të cilat marrin të gjitha masat për mundësimin sa më të shpejtë

të tranzitimit. Kur shtetet, që kërkojnë lejen për tranzitim për forcat e tyre ushtarake, nuk janë anëtare të NATO-s apo vende anëtare të PfP SOFA, dhënia e lejes së tranzitimit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6430, datë 24.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**